



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**AUTORITETI I KONKURRENCËS**

**VENDIM**

**Nr. 462, datë 23/ 05 /2017**

**Për**

**“Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregëtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumrave për bukë dhe nën produktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” SHPK.”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Juliana	LATIFI	Kryetare
Eduard	YPI	Zv/Kryetar
Koço	BROKA	Anëtar
Iva	ZAJMI	Anëtare
Leida	MATJA	Anëtare

Në mbledhjen e tij të datës 23.05.2017, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i Relacionit të Sekretares të Përgjithëshme mbi “Ankesën e paraqitur nga Z. Hysen CAKA, Z.Ardian CAKA dhe Znj. Lima CAKA.

**Bazë ligjore:** Neni 9, pika 2, germa a), c) dhe ç); Neni 42, pika 1; të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar); Neni 4 i Rregullores “Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Relacionit të Sekretares të Përgjithëshme mbi vlerësimin ankesës së paraqitur nga Z. Hysen CAKA, Z.Ardian CAKA dhe Znj. Lima CAKA, lidhur me kufizimet e konkurrencës në tregun e tregëtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumrave për bukë dhe nën produktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes “Nelly” Sh.p.k

**VËREN SE :**

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës me datë 12.04.2017, janë paraqitur Z. Hysen CAKA dhe Znj. Lima CAKA të cilët ushtrojnë aktivitet me objekt: “Prodhim dhe përpunim brumi, furrë buke”. Këta persona kanë paraqitur një ankesë, në lidhje me sjelljen e ndërmarrjes “Nelly” Sh.p.k e cila ushtron aktivitet në tregun e tregëtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumrave për bukë dhe nën produktet e saj.

2. Sipas ankimesve ndërmarrja "Nelly" Sh.p.k është distributor ekskluziv i produkteve "Maja" dhe "Miell" të markës "Zrnopan" të tipit "S", "Plus" dhe "T" të prodhuar nga kompania "Lesaffre" kompani Franceze, me qendër rajonale në Kroaci.
3. Ankimesit pretendojnë se janë ndodhur përpara faktit të mos furnizimit me këto produkte nga ndërmarrja "Nelly" Sh.p.k dhe për këtë arsye kanë kontaktuar në telefon me Z. Haki HOXHA administrator i ndërmarrjes "Nelly" Sh.p.k, i cili i ka deklaruar se nuk do ti furnizojë më, pasi ankimesit kanë hapur një Furrë Buke (Pikë Shitje) në zonën e "Don Boskos" përballë Furrës së Bukës së kompanisë "SOMEG" dhe konkurojnë këtë të fundit, i cili rezulton të jetë miku i Z. Haki HOXHA administrator i ndërmarrjes "Nelly" Sh.p.k.
4. Sipas ankimesve, ndërmarrja "Nelly" Sh.p.k është i vetmi distributor i këtij produkti në Republikën e Shqipërisë, produkt të cilin e importon nga Kroacia dhe sipas tyre ky produkt nuk ka zëvendësues të tjerë në vend, duke i dhënë ndërmarrjes "Nelly" Sh.p.k pozita "monopol" në tregtimin e këtij produkti, pozita të cilat ajo i përdor për të goditur ankimesit duke shkelur nenin 9 të Ligjit 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar).
5. Ndërprerja e furnizimit me këtë produkt i shkakton një dëm të rëndë dhe të pa riparueshëm ankimesve pasi këta të fundit kanë kontrata me të tretë për furnizimin me bukë speciale të cilat prodhohen me këto produkte, dhe mos përmbushja e kontratës i ngarkon me penalitete, gjithashtu ankimesit pretendojnë se 40 % të produkteve të bukës që tregëtojnë i prodhojnë me "Maja" dhe "Miell" të markës "Zrnopan" të tipit "S", "Plus" dhe "T" të prodhuar nga kompania "Lesaffre" me distributor në Shqipëri ndërmarrjen "Nelly" Sh.p.k.
6. Për sa më sipër, nga pretendimet e ankimesit si dhe faktet dhe provat e paraqitura prej tij rezulton se sjellja e ndërmarrjes "Nelly" shpk në tregun e tregëtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumrave për bukë dhe nën produktet e saj, duke refuzuar të furnizojë ankimesit Z. Hysen CAKA, Z.Ardian CAKA dhe Znj. Lima CAKA me produkte "Maja" dhe "Miell" të markës "Zrnopan" të tipit "S", "Plus" dhe "T", bazuar në nenin 9, pika 2 të Ligjit 9121/2003 mund të pengojë, kufizojë ose shtrëmbërojë konkurrencën në këtë treg, duke vendosur në kushte të pafavorshme konkurrence ankimesit.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 9, pika 2; 24, germa d) dhe 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar),

#### **VENDOSI:**

1. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregëtimit të produkteve lëndë e parë për prodhimin e brumrave për bukë dhe nën produktet e saj, konkretisht ndaj ndërmarrjes "Nelly" Sh.p.k, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

2. Hetimi Paraprak do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2017 deri me 15.05.2017.
3. Raporti i Hetimit Paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës, jo më vonë se 3 muaj nga marrja e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**